



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060-21286 dt. 24.05 2021

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Labinot Halilaj, më datë: 31/05/2021 (e hënë) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas i dt. 28.04.2021
2. Raporti i përditësuar epidemiologjik i Komunës së Drenasit lidhur me pandeminë me Covid-19 (vir.SARS-COV2) Mars-Maj 2020-2021 si dhe procesi i deritanishëm i imunizimit–(vaksinimit)
3. Propozim vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit për monitorimin e Kodit të Etikës.
4. Propozim-Diskutim i Raportit të punëve të Kompanive KRM (Pastrimi) dhe KRU- (Prishtina) në Drenas.
5. Të ndryshme.

Drenas, 24.05.2021



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit



Kuvendi i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLLOGOC GLLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		24.05	2021
Nj. Orig.	Numër	Shtojca	Vlera
12-	060-	21286	

Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 24.05.2021, si vijon:

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K.P.F-ca për rendin e ditës, ku të gjithë anëtarët e K.P.F-ca u pajtuan me këtë rend dite, dhe e votuan në mënyrë anonime:

1. **Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt.21.04.2021.** pasi nuk pati diskutime, vrenjtje apo sugjerime u kalua ne mënyre unanime.
2. **Raporti i përditësuar epidemiologjik i Komunës së Drenasit lidhur me pandeminë me Covid-19 (vir.SARS-COV2) Mars-Maj 2020-2021 si dhe procesi i deritanishëm i imunizimit-(vaksinimit),** pas sqarimit të drejtorit të shëndetësisë Arsim Haxhiu, nuk pati diskutime tjera dhe kjo pike e rendit të ditës u rekomandua për kuvend.
3. **Propozim vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit për monitorimin e Kodit të Etikës.** Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime dhe kjo pikë e rendit të ditës u sugjerua për kuvend.
4. **Propozim-Diskutim i Raportit të punëve të Kompanive KRM (Pastrimi) dhe KRU-(Prishtina) në Drenas.** Pas sqarimit të Drejtoreshës Lumnije Krapu nuk pati diskutime tjera edhe kjo pikë e rendit të ditës u sugjerua për kuvend
5. **Të ndryshme.** Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoj në ora 10:56 min.



Kryesuesi i Kuvendit

Labiriot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/04-21296 dt. 24.05 2021

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
28.04.2021**

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 28.04.2021

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 28 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas e dt. 26.03.2021.
2. Raporti financiar i zhvillimit të buxhetit Janar Mars 2021
3. Raport i ndihmave dhe subvencioneve për vitin 2020
4. Propozim Vendim për bartjen të hyrave vetanake nga viti 2020, në vitin 2021.
5. Propozim vendim për caktimin e anëtareve te komisionit përzgjedhës nga Komuna për drejtor dhe zëvendësdrejtor në institucionet publike Edukative-Arsimore të Komunës së Drenasit.
6. Propozim vendim për shfuqizimin e pikës 11, të nenit 3 të vendimit nr. 12-353-31851 të datës 23.07.2014, që ishte dhënë prona komunale në shfrytëzim Vjollca Gashit nga Komorani.
7. Propozim vendim për lirim nga taksa e operimit të bizneseve dhe lirimit nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike për bizneset e gastronomisë për vitin 2021.
8. Propozim vendim për ndryshimin e koordinatorit të KKS-së.
9. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 28.04.2021 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, si dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse, shefi i kabinetit të kryetarit Flamur Curri.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, jemi në mbledhjen e rregullt të kuvendit të komunës konstatoj se prezent në mbledhje janë 28 anëtar, a keni diçka para se me fillu me rendin e ditës:

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- ne i kemi edhe 4 pika shtesë me i propozu për këtë mbledhje, materialin ia keni përcejell në imell:

1. Propozim vendim për caktimin e anëtareve të komisionit përzgjedhës nga Komuna për drejtor dhe zëvendës drejtor në institucionet publike Edukative-Arsimore të Komunës së Drenasit.
2. Propozim vendim për shfuqizimin e pikës 11, të nenit 3 të vendimit nr. 12-353-31851 të datës 23.07.2014, që ishte dhënë prona komunale në shfrytëzim Vjollca Gashit nga Komorani.
3. Propozim vendim për lirim nga taksa e operimit të bizneseve dhe lirimit nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike për bizneset e gastronomisë për vitin 2021.
4. Propozim vendim për ndryshimin e koordinatorit të KKS-së. Ju ftoj ta votoni.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar dhe votuan në mënyrë anonime me:

28 vota për, 00 vota kundër 00 vota abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas e dt. 26.03.2021.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar dhe votuan në mënyrë anonime me:

29 vota për, 00 vota kundër, 00 vota abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj: hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2.Raporti financiar i zhvillimit të buxhetit Janar-Mars 2021

Shyqeri Bublaki- do t'ju njoftoj për raportin janar-mars 2021, do ju njoftoj për buxhetin fillestar dhe realizimin e të hyrave, buxheti fillestar për Komunën e Drenasit për vitin 2021 është zvogëluar për shkak të pandemisë për 15.399.334 €, ndërsa sa i përket realizimit të hyrave vetanake për periudhën janar-mars, trendi i realizimit të hyrave vetanake për periudhën janar-mars është 265.582.76 € apo 81.30% është një trend jo i mjaftueshëm në bazë të planit mirëpo duke e marrë situatën e pandemisë dhe është pa të hyra të gjobave të trafikut dhe gjobave të gjykatave dmth vetëm të hyrat direkte të komunës së Drenasit, ndërsa sa i përket shpenzimit të buxhetit i keni në tabelën e fundit të paraqitura për secilën kategori të shpenzimit të buxhetit, për paga ka qenë ndarje buxhetore sipas sistemit të menaxhimit të financave publike **2.260.001.23 €** përqindja është qind për qind, për mallra dhe shërbime buxhetin e alokum apo ndarë për kohen që po raportojmë është **818.288.69 €**, apo shpenzimi është **449.812.29 €** apo 54.97 %, shpenzimet komunale janë: **42.754.47 €** shpenzimi është **37.974.28 €** apo 88.82 %, subvencione dhe transfere alokime kemi **83.614.24 €** pra shpenzimin e kemi **24.036.83 €** apo 28.75 %, ndërsa investimet kapitale i kemi **2.881.998.25 €** apo shpenzime të alokuara **411.020.55 €** apo 14.26 % për periudhën që po raportojmë është një përqindje mjaft e mirë, totali për periudhën që po raportojmë është **6.086.656.88 €** shpenzimi është **3.182.845.18 €** apo 59.29 %.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi kaloi të pika tjetër meqë kjo pikë e rendit të ditës nuk votohet.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3.Raport i ndihmave dhe subvencioneve për vitin 2020.

Shyqeri Bublaku- kemi filluar me raportimin e ndihmave që ndahen nga Komuna e Drenasit për qytetaret e komunës, bujqit, dhe kategoritë tjera, ndarja e këtyre subvencioneve bëhet në bazë të rregullores të Kuvendit Komunal e cila është e hartuar në bazë të ligjit për vetëvrasje lokale. Zyra e kryetarit gjatë vitit 2020 ka ndihmuar tre student me vlerë prej 1500 €, drejtoria për Shërbime publike për vitin 2020 ka subvencionuar në vlerë prej 6273, 69 €, këto janë kryesisht qytetare të komunës të cilët janë dëmtuar nga fatkeqësitë elementare p.sh. vërshimet, zjarret. Drejtoria për bujqësi dhe zhvillim rural ka subvencionuar në shume prej 48,348.47 €, grupet të cilat janë subvencionuar janë furnizimi me centrifuga për bletari, sera për gra të marginalizuara, fermer të cilët janë furnizuar me mikser për ushqimin e kafshëve dhe fermer që janë furnizuar me sera, këto janë disa që janë furnizuar nga drejtoria e Bujqësisë. Drejtoria për zhvillim ekonomik ka subvencionuar firma të dhënë pronë komunale me qira janë liruar nga taksat bizneset sipas nenit 13 të rregullores komunale për taksa ngarkesa dhe gjoba, 41 bizneseve janë dhënë prona komunale në shfrytëzim për të shkurta kohore në parkun e biznesit, janë ndihma që komuna iu ka afër bizneseve për të zhvilluar biznesin, duke marrë parasysh që viti 2020 ka qenë vit pandemie Drejtoria për administratë dhe shëndetësi iu ka ndarë pako ushqimore dhe pako higjienike që ju kanë ndarë qytetarëve të cilët kanë qene të prekur nga covid-19 të cilët kanë qenë të mbyllur, dhe shuma e ndarë për vitin e kaluar është 204.000.40 € dmth ka qene furnizimi i pakove ushqimore dhe higjienike për periudhën e pandemisë, miell për skamnor, 50 familje me banim social ku iu ka heq qiraja për banim social për vitin 2020. Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sport për vitin 2020 ka subvencionuar në shumë prej 79.700.000 €, ku ka subvencionu klube sportive, klube shoqëror- kulturore dhe artistike, klube shkrimtarë, shuma totale nga Komuna e Drenasit, drejtoria e arsimit shuma e ndarë prej 92 mijë euro për student janë dhënë bursa për student dmth shuma prej 92 mijë janë ndarë gjithsej 184 bursa. Shuma e subvencioneve për vitin 2020 nga Komuna e Drenasit prej 270 mijë sa ka qene buxheti i planifikuar e kemi rrit shumën me 430.330.64 euro .

Vehbi Berisha- e kam lexu këtë raport, i falënderoj për këtë raport të detajuar ku janë të gjithave përfshirë të gjitha kontaktet, sasia, koha e shfrytëzimit të këtyre tokave, pronave, banesave të gjitha, dua ta ngriti një qeshje, z. Bashkim Deliu-t ia keni dhënë një banesë e cila ka vetëm një dhomë ditore dhe një banjo, i cili e ka postu në rrjetet sociale në facebook dhe e kam shiku që kushtet nuk janë të mira, komisioni nuk e kanë lejuar me e shiku një herë banesën pa e nënshkru kontratën kështu më ka thënë pa ju akuzuar juve, sepse pa i degju të dy palët kurrë nuk mundesh me e marrë një përfundim, dashta me e ditë a e ka pranë këtë banesë, a është duke banuar, sa anëtar të familjes ka, kërkoj një sqarim?

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu- lidhur me të gjitha ato që i përmende qeshtja rreth procedurës së ndarjes, komisioni e ka shqyrtu e ka bërë ndarjen të cilën ju keni marrë vendim në kuvend, qeshja e banesave jo vetëm ajo po në përgjithësi ne e kemi bërë edhe një kërkesë dhe jemi në vazhdimësi të kërkesave të ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor, në mënyrë që të kemi një shumë të mjeteve që me i rinovu në përgjithësi të gjitha banimet, ajo banesë ka qenë një

lokal sipas projektit, ka qenë një lokal i dedikuar për afarizëm të mundshëm për ato mirëpo ka vite që ajo hapësirë mbetet si rezerve e cila shfrytëzohet për raste kalimtare që i themi, për muaj apo për probleme të shërbimeve sociale, ndarje familjare apo ndonjë rast i tillë, ai ka hy në mbledhjen fundit të komisionit e ka shiku nuk i ka pëlqy e ka refuzu, sipas të dhënave ai i ka dy djem të moshës madhore, njeri mbi moshën 18 vjet tjetri 16-17 nuk kemi të dhëna tjera që ka anëtar tjerë të familjes, dhe në atë sa kemi pas mundësi iu kemi afuar mirëpo ai nuk ka pranuar.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- ne kemi bërë gjithçka që është e mundshme për z. Deliu i cili jeton vetëm me dy fëmijët e tij, komisioni e ka shqyrtuar e ka aprovu, ju e keni miratu, ai nuk ka dashtë me qëndrua aty, ato kushte janë në banesa sociale nuk ka kushte tjera, z. Deliu komuna ia ka ndertu shtëpinë në fshat e cila është gati e përfunduar i kemi thënë që shtëpia është ne përfundim mirëpo ai ka thënë që nuk kthehet në fshat. Të z.Deliu i kemi shqyrtuar të gjitha mundësitë për shkak të gjendjes shëndetësore sipas raporteve që i kemi pas, me asnjë rregullore nuk i takon banesa në banim social sepse kemi raste ku i përmbushin kriteret dhe ata kanë përparësi, mirëpo ia kemi dhënë atë mundësi për shkak të gjendjes shëndetësore që e ka vet ai.

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu, ju i keni propozim vendimin, vendimin që u miatu ne kuvend, i keni me numër me metër katror, komisioni fillimisht ka shqyrtuar tri raste dhe rastin katër mirëpo ato janë kapacitetet që i ka pas komisioni ne dispozitë për ndarje.

Sokol Bylykbashi- ketë çështjen që e shtroi kolegu Berisha edhe mua me ka shkruar Bashkim Deliu edhe është ankuar për përzgjedhjen që e kemi bërë ne, problemi nuk është që ka ndërru nga propozim vendimi me gjendjen në terën, por ai thotë që drejtori i shëndetësisë i ka thënë së kemi me ta dhanë një banës në katin e tretë me 60 metra katror e cila ka dhoma sallon dhe ballkon përcjellës mirëpo, kur ka shkruar ka gjetë krejt diçka tjetër ka gjetur një bodrum me 20 metra², sipas tij gjithmonë, i cili është i pabanueshëm dhe nuk mund të qëndroj aty askush, për këtë arsye ai e ka refuzuar dhe tash qëndron sipas tij tek të afërmit e tij, e përmendi edhe kryetari e di që kane një gjendje të rëndë edhe ekonomike edhe shëndetësore dhe kanë familjar të humbur në luftën e fundit. Unë nuk di detaje shumë dhe nuk jam ai që i vlerësoje as kriteret sepse nuk jam marrë me atë rast por gjithmonë sipas tij, di që diçka në vija të trasha por mendojë megjithatë është mirë që mbajte fjalën nëse ka dhënë dikush sipas tij po them prapë është mirë që mbajti fjalën sepse njerëzit kanë halle dhe presin realizimin e fjalës.

Kryetari i Komunes z. Ramiz Lladrovci- askush nuk jep fjale që nuk janë në përputhje me ligjin. Ne jemi në vit zgjedhor, ju e dini sa herë kemi zgjedhje Bashkim Deliu na del përpara. Me rregullore nuk i ka taku, banimi social është i përkohshëm, banimi social gjithkush duhet me ekuptu që është i përkohshëm.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, pasi që kjo pikë nuk votohet kaloj tek pika tjetër, meqë nuk pati diskutime tjera.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj: hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:
4.Propozim Vendim për bartjen të hyrave vetanake nga viti 2020, në vitin 2021.

Drejtori i Financave Shyqeri Bublatku- dihet se Komuna e Drenasit në vitin 2020 ka realizuar të hyra vetanake në shumë prej 1.297.954.59 €, shuma e përgjithshme e cila duhet të barten me propozim vendim është 1.135.436.89 € shpërndarja e bartjes se këtyre do të bëhet sipas shumave për kategori ekonomike, dmth për mallra shërbime kemi shumen prej 36.122.04 €, për subvencione dhe transfere: 18.362.04 € dhe për investime kapitale 1.80.952.81 €, kjo shpërndarje bëhet sipas drejtorive dhe zyrës komunale dmth mallra dhe shërbime i kemi në shëndetësi shuma prej 11.999.17 €, në arsim parashkollor dhe çerdhet shuma prej 24.122.87 €, shuma totale është 36.122.04 €. Subvencionet dhe transferet zyra e kryetarit i ka 4.903.50 €, Drejtoria për Administratë shuma është 250.00 €. Drejtoria për infrastrukturë rrugore shuma prej: 92.94 €, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural shuma prej 1.912.30 €, Drejtoriati i Administratës Shëndetësi në shume prej:

Në programin e Administratës së Arsimit dhe Shkencë (920) nën-program (92005) me kod funksional(0980),do të barten këto mjete në investime kapitale si vijon: Rrethoja e oborreve të shkollave me nr, të proj. (48240) me shumë prej: 5.215.00 €.Riparimi i nxemja qendrore (radiator dhe pajisje tjera përcjellës , me nr.te projektit (49197) me shumë prej:15.430.15 €. Totali në investimi kapitale në Administratën e Arsimit 20.645.15€.Mallra dhe shërbime 36.122.04 €, Subvencione dhe transfere18.362.04 €

Vehbi Berisha- kërkoj një sqarim nga drejtori, sepse e kemi shiku këtë propozim vendim që ka një shumë për bartje 1.1 milion, ndërsa të arsyetimi thotë ë vetëm rrethojat e oborreve të shkollave afër 5 mijë euro ka mbet pa u pagu që u dashtë me u bartë, pse kanë mbet këto mjete?

Drejtori i Financave- Shyqri Bublatku- Shuma prej 5215 € ka qenë shumë e procesor nga ana e kuvendit Komunal, është shumë me thesar u bë pagesa, mirëpo na kanë anuluar më dt.11.012021 është anuluar pagesa dhe të arsyetimi e ke projekti, rrethoja e oborreve të shkollave'' (48240) me shumë prej: 5,215.00 € edhe pse është procesuar pagesa nga certifikuesja me datën 24.12.2020,Departamenti i Thesarit e ka anuluar për shkak të bilancit bankar ,dhe tani me bartjen e të hyrave vetanake 2020 në vitin 2021, me buxhetin e këtij projekti do të, shlyhet obligimi i trashëguar nga viti i kaluar.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci- Ne i kemi pasur në buxhet të aprovuara për rritje të pagave, është anuluar për shkak të ankesës që e ka bërë avokati i popullit, ato mjete na e kanë bërë të mundshme me i shfrytëzu në kapitale dhe ne i kemi shfrytëzuar ato dhe na kanë tepruar, i kemi diskutu, kemi bërë pagesa, ne kemi edhe borxhe të vitit të kaluar që ne kemi qenë në rregull, projektet i kemi paguar mirëpo thesari nuk ka pas mjete jo vetëm neve mirëpo gjitha komunave, jemi duke diskutuar me kolegjin e kryetareve me qeverinë si me zgjidhe këtë çështje sepse ato mjete i kemi ndarë në kode ato projekte që i kemi dy vjeçare nuk mundemi me i pagu nga ato sepse duhet me e gjet një kod, mirëpo ne i kemi dorëzuar.

Sokol Bylykbashi- Kur jemi në vitin e fundit, të një mandati qeverisës kalkulime politike edhe ekzistojnë, edhe sa i përket draft-buxhetit të fundit të atij mandati edhe sa i përket shqyrtimit të buxhetit të fundit edhe sa i përket bartjes së fundit pra brenda tij të hyrave vetanake brenda këtij mandati qeverisës si shumë po më doket e madhe, dhe është shuma me e madhe që kemi bartë mua më duket që është për kalkulime politik, por çka nëse kemi pas nevojë dhe ku kemi pas nevojë këto mjete me i shpenzu?

Drejtori i Financave Shyqeri Bublaku- edhe vitin e kaluar e kemi bartë shumë prej 1 milion e 116 mijë euro, grandet nuk barten vetëm të hyrat vetanake çdo kuvend komunal çdo komunë interesohet që shpenzimin e grandëve të ndara nga qeveria ta shpenzoj në maximum sepse ato mjete nuk barten ato shkojnë suficit ndërsa të hyrat vetanake barten jo vetëm një vit por edhe pas 10 viteve i bartë secilin vit veq e veq, të hyrat vetanake të vitit 2020 është shpenzu shumë prej 716 mijë euro ndërsa na buxhetin për shpenzime kapitale nuk ek kemi pas as 5 milion të buxhetuar dhe kemi arrit me shpenzu shumë prej 5 milion vitin e kaluar, është viti që kemi bërë shpenzime me shumë ma të madhe.

Vehbi Berisha- çdo propozim që ka ardh për bartje se pari ka ardh të preambula së pari nga kanë ardh ato mjete e pastaj ka vazhduar pjesa tjetër se ku po i destinon, ndërsa këtu nuk figuron fare se nga kanë ardhur, është dashur edhe një arsyetim më pas.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci-- Ne kemi fitu edhe grande tjera pra ku kemi fitu grandet nuk i kemi shfrytëzuar të hyrat vetanake. Të hyrat vetanake pavarësisht që është mirë krejt më i fut në investime, nuk kemi kapacitet më i fut më shumë, por unë nuk kam inxhiniera , nuk kam zyrtar më i përcjellë punimet në të gjitha ato projekte që janë bërë për ata edhe i kemi zvogëluar tenderat më qenë më pak mos më qenë 180, 60 , duhet të kontrollohen më mirë. Ne kemi pasur edhe grande kemi fituar edhe donacione i kemi ruajtur ato të hyra vetanake. Të hyrat vetanake i kemi diskutuar në këtë kuvend dhe me keni akuzuar pse nuk i kemi harxhuar – shpenzuar, ato i kemi bartur. Ju mund te thoni pse i keni bartur në këtë projekt e jo në atë projekt.

Shyqri Bublaku- Vitin e kaluar i kemi pasur prej grand performancës shumë prej 325 mijë eurosh, d.m.th ai grand është shfrytëzuar tërësisht prej këtij grandit 325 mijë euro i kemi bartje sivjet na janë bartë, se i kemi shpenzuar mbi 90% grandin edhe 3 mijë e 300 euro që na shtohen në këtë vit të hyrat.

Sokol Bylykbashi- Deshta më e bërë një kërkesë pasi jemi të kjo bartje të një vlerë kaq të madhe dëshirojë të flas pak për varrezat e dëshmorëve në Terstenik konkretisht tek ''Lisi i Binak'' siç e quajmë ne. Ju keni qenë si komunë dhe po i shoh disa fotografi me d.t 12 prill keni bërë homazhe, në fshatin Terstenik janë të vetmet varreza të pa rregulluara, janë ashtu siç kanë qenë nga pas lufta, unë kërkoj që ta shikoni pak këtë bartje dhe nëse nuk e keni të parashikuar për këtë vit me u bërë rregullimi i këtyre varrezave për këtë ta ndajmë një shumë, dhe t'i rregullojmë këto varreza, për arsyeje se është e padinjitetshme që 20 vite m i lënë pa i rregulluar.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- shqetësimin para jush, kjo është nen menaxhimit e agresionit për menaxhimin e monumenteve pra është z. Bislim Zogu që e udhëheq atë agjenci, agjencinë ka mbi 40 milion ose 60 milion euro vetëm për këto qëllime dhe agjencionit duhet me iu bërë kërkesë sepse agjencioni e ka obligim për këtë qëllim, ne kemi dashtë me ndërhy por nuk kemi të drejte.

Sokol Bylykbashi- e di që agjencioni e ka për obligim më i rregullu këto monomente dhe varreza mirëpo a mundeni me e bërë një kërkesë si kryetar komunë me autoritetin dhe përgjithësinë që e keni dhe besoj që e ka peshën e vet.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- patjetër që mundemi, nuk kemi bërë kërkesë vetëm për atë por kemi bërë edhe për vend varrezat të tjera, mirëpo që keni dhe ndonjë kërkesë tjetër e adresojmë për këtë qellim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjate votimit janë 28 anëtar, votuan me:
Për 26, kundër 00 Abstenim 2.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj: hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:
5. Propozim vendim për caktimin e anëtareve të komisionit përzgjedhës nga Komuna për drejtor dhe zëvendës drejtor në institucionet publike Edukative-Arsimore të Komunës së Drenasit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal z.Labinot Halilaj, si anëtar përzgjedhës nga ekzekutivi është Arbësa Haziri, dhe nga Arben Haziri nga këshilli i prindërve.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci- ky është një vendim që e ka kërkuar ministria për intervistimin për zgjedhjen e drejtorëve çoftë të arsimit çoftë institucioneve tjera na duhet dy anëtar dhe ne ia propozojmë kuvendit që t'i votojë këta dy anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjate votimit janë 29 anëtar, votuan me:
Për 29, kundër 00 Abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:
6.Propozim vendim për shfuqizimin e pikës 11, të nenit 3 të vendimit nr. 12-353-31851 të datës 23.07.2014, që ishte dhënë prona komunale në shfrytëzim Vjollca Gashit nga Komorani

Petrit Gashi- e shikova këtë propozim vendim dhe të gjitha ishin edhe në arsyetim por janë disa gabime teknike psh. të neni 2, thotë shfuqizohet pika 11 e nenit 3 e këtij vendimi e dt. 23.07.2021 dhe me siguri duhet me qenë 2014, dhe i njëjti gabim është përsëritur ehe tek arsyetimi, kërkoj të përmirësohet te neni 2 dhe tek arsyetimi.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- gabim teknik, e përmirësojmë.

Petrit Sinani- pati një pyetje: pse nuk po shfuqizohet krejt kontrata por po shfuqizohet vetëm pika 11 e nenit 3?

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci-, krejt kontrata është shfuqizuar por ka një dokument ku fol për shumë prona prandaj kjo ka qenë prona e cila pasi e ka bërë vlerësimin komisioni na ka propozu që kjo ka qenë me u shfuqizu, e ki ne fund vendimin nr. 12-353/31831. E dt. 28.07.2014 janë 11 prona, shumica janë marrë deri me tani, ato që i kane plotësuar kriteret vazhdojnë aktivitetin e tyre, ndërsa kjo nuk i ka plotësuar i keni edhe me fotografi prandaj është kontrata e 11 me radhë në këtë vendim të kuvendit 2014.

Petrit Gashi- pyeti: dashta me ditë për këtë shfrytëzim të pronës po shihet që është ridestininim e ka përdor për diçka tjetër, a i kthen mjetet e qirasë operatori që ia ka marrë njerëzve që e kanë shfrytëzuar atë pronë?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- çdo kush që e ka marrë në shfrytëzim kontakte pas kontrate, është problem i tyre si veprojnë.

Sabrije Kukaj- prona e z.Thaqi që është në Komoran që iu ka dhënë për drugdhendës ai e lëshon me qira dhe material ndërtimore një pjesë të saj, jo vetëm tani por gjithmonë e kam cek se vazhdon të jete e njëjta prej si ju ka dhënë.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci-- ne ia kemi dërguar komisionin, komisioni e ka bërë një vlersim, ka pas, nuk ka pagu as edhe qira, ju ne këtë kuvend ia keni ndrru qiranë nga një 1 ne 2, 28 mijë euro e kam detyruar me i pagu, me sa e kam shiku ne konform të kontratës është duke punuar, nëse nuk është duk punuar në konform të kantatës komisioni mban përgjithësi por megjithatë ne e kemi edhe obligim ligjor çdo 6 muaj me dergu komisionin për me e shiku.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjate votimit janë 29 anëtar, votuan me:
Për 29, kundër, 00 Abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për piken e 7 të rendit të ditës:
7.Propozim vendim për lirim nga taksa e operimit të bizneseve dhe lirimit nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike për bizneset e gastronomisë për vitin 2021.

Petrit Gashi- ky propozim vendim është një nder propozim vendimet me të mira që ka ardh, shpesh here kemi kërkuar lirimin e bizneseve nga taksa komunale për shkak të kushteve të vështira që po operojnë ne komunën tone por edhe për shkak pandemisë që kanë ndikuar shumë që këto biznese të dëmtohen të gjitha ishin në arsyetim, por unë e kam një sqarim që kanë kerkuar disa nga bizneset, disa nga kompanitë e e transportit me kanë pyetur dhe disa kompani tera që janë jashtë gastronomisë me ditë që a lirohen të gjithë bizneset në Komunën e Drenasit apo jo, kërkoj një sqarim për qytetaret.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci-- të gjitha bizneset që operojnë ne Komunën e Drenasit nuk ka dallim për taksen e operimit lirohet, ndërsa për gastronominë për kafiterite i kemi liruar edhe për terasa, ata që kanë paguar sepse ka nga ata që i kanë paguar por i bartin për vitin tjetër.

Petrit Sinani- qëllimi i pyetjes a ka edhe biznese tjera të cilat i shfrytëzojnë hapësirat publike edhe shfrytëzojnë gastronominë ?

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci-, nuk i lirojmë ata, ne i lirojmë vetëm gastronomisë për shkak të pandemisë, taksen e operimit dhe terasat për gastrenominë publike që i kemi në kontratë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit janë 29 anëtar, votuan me:
Për 29, kundër, 00 Abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Propozim vendim për ndryshimin e koordinatorit të KKSB-së.**

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 asamblistë dhe votuan me:
Për 29 vota, kundër 00 vota, abstenim 00 vota.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës ndryshme: **9.Të ndryshme.**

Sabrije Kukaj unë kam dy pyetje për te kjo pika të ndryshme të gjithë e kemi pa që ne oborr të shkollës po ndërtohet diçka çerdhe , unë nuk e di që ka ardh në kuvend kërkesa për ndërtim të çerdhes në oborr të shkollës ose jam gabim unë , ky kuvend nuk ka marr vendim për ndërtim të çerdhes në oborr të shkollës ,dhe e dyta KEDS-i që po i fut kabllot e rrymës po e prenë asfaltin në disa vende ,a ka dal dikush me shikuar si është gjendja e rrugëve ku po prehet asfalti a po riparohet ajo ,dhe e treta dua me pyet drejtoreshën këtu te rrethi a ke dal me pa si është rruga me gropa dhe a është rrezik për ndonjë ndeshje duke u munduar njerëzit me ju ik gropave .

Kryetari i komunës Ramiz LLadrovci –ky Kuvend e ka aprovua ndërtimin e çerdhes në pjesën e oborrit të shkollës dhe është dedikuar për atë qëllim, pra ne nuk kemi mundur as me nis proceduar ,as me fitua donacione ,garantin prej bashkimit evropian pa i kaluar ,kemi pasur edhe disa telashe me i larguar ujërat e zeza edhe me larguar rrjetin elektrik ,pra të gjitha janë diskutuar në këtë Kuvend dhe ka leje dhe jam i lumtur që jemi në mesin e komunave që ka përfituar grant për ndërtimin e çerdhes moderne në Komunën tonë, sa i përket pyetjes se dytë për dëmtimet që i bërë KEDS-i ne i kemi adresua shqetësimet dhe ankesat ,një takim me Drejtorin e investimeve të Kedsit ata i kanë marr përsipër të gjitha kyqjet kanë me qenë me Drenas jo si i kemi fshatrat Gradica, Likoshani ,Godanci ,Polluzha me Skenderaj pastaj Komorani ose Nekoci me Lipjan etj të gjitha këto kanë me pas një rrjet të ri kjo është bërë fal asaj që ne i kemi pajisë me leje përkatëse dhe kemi pas një bashkëpunim të shpejt me ta sigurisht që dëme ka me pas edhe gjatë vazhdimit të punimeve por duhet me ditë që jemi duke u zhvilluar dhe duhet të kemi kujdes me shumë.

Sabrije Kukaj – me sa di unë çerdhet është marr vendim me u ndërtua njëra në Komoran e tjetra në Tërstenik ,mandej në Tërstenik doli diçka që nuk u ndërtua çerdhe ,por unë nuk e di që ky kuvend ka marr vendim për ndërtimin e çerdhes në oborr të shkollës ,dhe kisha pas dëshirë me pa atë vendim që është votuar në këtë kuvend dhe kur është marr ai vendim .

Vehbi Berisha- unë i kam tri pyetje për njërin prej pyetjeve i kam shkruar kryetarit por ndoshta nuk është bërë puna me kthyer përgjigjeje ,por e kam mundësin me e bërë prapë është fjala për pyetjen e parë për subvencionimin që ndodhi që qeveria ndajti do mjete për shtëpitë dhe

bizneset që u vërsjuan prej reshjeve, deshta me dit a janë subvencionua këto lokalet e reja ne Drenas kur e dimë që shumica prej tyre kanë qenë të vërsjuara komplet ,dhe pyetja e dytë është për kiosqet kur e dimë që i keni larguar kiosqet a keni në plan me i kthyer prapë apo çfarë është bërë me to ,dhe si pyetje e tret deshta me adresuar këtë çështjen e pronave të Qikatoves e pashe reagimin e Komunës dhe me pëlqej jashtëzakonisht që të gjithë hapat që i kishe marrë për me i dal zot asaj çështje mirëpo diçka mungoi aty, me sa kam informata këto prona ishin bart nga pronat private në pronën e ish AKPS se në atë kohë 20004 nuk ka qenë Feronikeli as i privatizuar por kanë qenë si prona në kuadër të AKPS, dhe ne vitin 20004 këto prona ishin bart dhe zyrtaret tonë kam pa edhe shkresa ku kanë thënë që nuk kemi njohuri mbi çështjen e kompensimit ,pse nuk e keni denosuar ata zyrtar qe kanë qenë në 20004 për shkak se nuk ka të bëj me juve ne këtu si Kuvend ju kemi përgëzuar për të gjitha ato dosje që i keni dorëzua për zyrtarët që ne të kaluarën kanë bërë lëshime ,si kanë mundur ata zyrtar me bart pronën kur kanë munguar të dhënat mbi çështjen e kompensimit ju faleminderit .

Kryetari i komunës Ramiz LLadrovci-pyetjes se par nuk të kam kthyer përgjigjeje sepse ka qenë në ëeb faqe të Komunës dhe aty ka qenë përgjigjja ,ne i kemi marr 168.000 nga ndarë Qeverija na ka zbrit për shume herë 30% të asaj që e kemi kërkuar unë i kam formuar 5 komisione për me i përfunduar punët më shpejt në Maj është parapare me u pagua një shumë edhe në Qershor nuk është ne dorën tonë kjo varet prej qeveris ,kur të regjistrohen si furnitor të gjitha ata që ka vendos komisioni që e ka vlerësuar komisioni që u është bërë dëmi do te përfundohen ,e dyta ke kiosqet nuk kemi projekt për kiosqet një herë për një herë sepse jemi duke i bërë hartat zonale edhe për këto kemi probleme kur të zgjidhen këto probleme do te shikojmë, ato që i kemi larguar kanë qenë krejt pa leje , sa i përket pronave të Qikatovës jemi merr shumë, pronat i ka vendos në sistem AKP-ja dhe janë prona të saj ,një pjesë të tyre po donë me i shitë edhe një pjesë me i ruajt për dëmet ose pagesa nëse nuk është bërë ndonjëherë ndonjë pagës e ndokujt kur të fiton gjygin me e paguar ,të gjithë këta qytetar tonë që po ankohen në vitin 2006 e kanë pas një dokument prej AKP-së ku janë thirrë me ardhë në AKP dhe me thënë qe kjo është prona e jonë e cila nuk ka marr epilog përfundimtar ose nuk është paguar . Vehbi Berisha si është e mundur se AKP-ja këto prona nuk ka mundur me i bart vetë po ka ardh në Kmunë dhe me krekës të tyre i kanë bart në pronësinë e tyre ,si është e mundur që ata zyrtar komunal me ia bartë, pa sjell fakte që janë kompensua dhe kaq .

Kryetari i Komunës Ramiz LLadrovci- pronat kur të i vërtetoi se janë bërë në mënyrë të jashtëligjshme ata që i kanë bërë këto gjera do të merren me gjykatën ajo vendos a ka qene gabim a jo .

Sabrije Kukaj – është fletorja me emra të personave se sa ari ju kanë marr kur janë bashkuar tokat me kooperativën ,janë datat kur janë kthyer janë pagua e ka njeriu fletoren ka shkuar në AKP, ju ka thënë që nuk mundeni me i shite këto toka sepse njerëzit i kanë paguar si dëshmi e kam fletoren me numër të parcelave dhe nuk e kanë marr parasysh ,dhe ka plotë toka që tash qytetareve qe kanë pas babë e babagjysh që i kanë bashkuar tokat me kooperativa kanë me i qite tani në shitje si ne Nekoc, Komoran, Polluzhë, Kishnarek ,Verboc në zëmër tokës që e ka p.sh e ka një hektar që e ka bashkuar atëherë me kooperativën tash i del pronë e AKP-së kjo është një tronditje për njerëzit, është personi unë mundem me ta sjell me emra me numra të parcelave ka sa ari i kanë pas të bashkuara me kooperativën kur janë marr dhe kur janë kthyer është tjetër gjë që atëherë baballarët tanë nuk kanë ditë procedurat me shkuar ne Komunë edhe me i përkthyer tokat edhe faktikisht dikush pas lufte ju ka dhanë ato prona AKP-së e tash po ka shumë

probleme, një zyrtar i AKP-së kur ka ardh një herë ne Polluzh ka thënë që edhe shtëpinë e keni në pronat e AKP-së.

Kryetari i Komunës Ramiz LLadrovci- me të gjitha këto problem është bërë një katrahurë në këtë sistem po mundohem i rregullua gjërat përmes gjykatës.

Beqir Kiqina -përsëendetje për të gjithë deshta me ia para shtruar një pyetje ekzekutivit me herët e përmendi edhe kolegu Vehbi Berisha sa i përket kompensimit të dëmeve nga vërshimet natyrore që kanë ndodhe sepse qytetaret janë shumë të interesuar përveç bizneseve që do të u kompensohen dhe shtëpitë e dëmtuara private ,a janë evidentuar të gjitha dhe kur është koha që ato të kompensohen të gjitha, edhe ekonomit familjarë përveç bizneseve .

Kryetari i Komunës Ramiz LLadrovci-komisionet i kanë bërë vlerësimet ne i kemi dërguara ne nivel qendror , për ata që na i kanë dhënë na kanë caktuar shumë kemi kërkuar me ardh me u bërë furnitor edhe me ia pagua por ende nuk kanë ndarë buxhet për ata çështje dhe unë besoi së ka me u zgjidhë kjo çështje për këtë arsye ne i kemi formuar 5 komisione që asnjë komunë nuk e ka bërë .

Sokol Bylykbashi- po dua me paraqit një ankesë dhe një krekës ,ankesa ka të bëjë me kundërshtimin e një gurëthyesi që po tentohet me u ndërtua në Nekoc nuk e di a ka aplikuar për leje dhe komuna ai ka dhënë leje dhe faktikisht kjo po me intereson mua ,dyta sa i përket lejes prej Qeveris nëse është e pa përshtatshëm jam i sigurt që nuk e japin se nuk kanë me shkuar gjërat si kanë shkuar deri me tash.

Kryetari i Komunës Ramiz LLadrovci-kur të informohesh se kush është pronari që ka bërë kërkesë edhe që po donë me bërë gurthyes të japim përgjigjeje ,nuk kemi përgjigjeje se nuk kemi asnjë kërkesë, por nëse i takon me ligj duhet me e dhënë nëse jo atëherë mbetet jo.

Sokol Bylykbashi –e kam edhe një krekës për me asfaltuar në rrugë në Qikatovë të Vjetër ,rruga Beqir Avdyl Morina me gjatësi rreth 300 metra faleminderit.

Kryetari i Komunës Ramiz LLadrovci-Sokol të gjitha rrugët që i kemi të parapara për me i asfaltuar si vjet kemi me i përfunduar ,vetëm se duhet të dimë ajo rrugë a është pronë private a publike sepse nëse është privatë nuk behët nëse është publike do të përfundohet.

Petrit Gashi-e kam një pyetje nga sektori I Bletarisë sepse po e kalon një krizë të madhe në tërë Kosovën jo vetëm në Komunën tone këtë vit ky sektor dhe kanë pyetur se a ka ndonjë plan komuna për subvencionimin e tyre ose për kompensimin e dëmit në çoftë se e sheh një komision të arsyeshëm sepse kanë pas humbje mjaft të mëdha.

Kryetari i Komunës Ramiz LLadrovci- sa i përket dëmeve është ne përgjegjësin e nivelit qendror, por ne si Komunë do të shohim se a mundemi me bërë diçka në këtë drejtim.

Mbledhja përfundoj rreth orës 12:35

Procesmbajtëse:

Liridona Fejza-Ajazi 

Fakete Hoti 

 Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
Drejtoria për Shëndetësi e Mirëqenies Sociale


№ Nr 052-1987 dt 17.05 2021

**RAPORTI I PËRDITËSUAR EPIDEMIOLOGJIK I KOMUNËS SË DRENASIT LIDHUR ME
PANDEMINË ME COVID-19 (vir.SARS-COV2) MARS - MAJ 2020-2021
SI DHE PROCESI I DERITASHËM I IMUNIZIMIT - (VAKSINIMIT)**


DRENAS, MAJ 2021




Situata Epidemiologjike sipas nr. të Testeve Pozitive në CoV-19



Infeksionet Mujore me CoV-19 Drenas 2020-2021



Nr.Testeve Pozitive rT-PCR sipas muajve / Drenas 2020 - 2021




Perfshirja e Infeksionit me SARS-CoV2 Drenas sipas gjinisë


M	F
1021	844
54.75%	45.25%

Totali
1865

Epidemiologjia me SARS-CoV2 sipas Gjinisë / Drenas
2020-2021




Epidemiologjia sipas GR.moshave Test Pozitiv SARS-CoV2



VDEKSHMËRIA - MORTALITETI në CoV-19 / Drenas 2020-2021


Deri 20 vjeç		21 deri 40 vjeç		41 deri 60 vjeç		61 deri 80 vjeç		mbi 80 vjeç	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
0	0	2	0	7	4	25	20	8	3
0		2		11		45		11	
69									

Vdekshmëria sipas grup moshave nga CoV-19 / Drenas 2020-2021



Mortaliteti sipas gjinisë CoV-19 Drenas 2020-2021

■ Totali: M ■ Totali: F





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 0204-19925 dt. 17/05 2021

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 33 paragrafi 8 të Kodit të Etikes Nr. 12-070/01-51560, miratuar në Kuvendin e Komunës së Drenasit me datë 26.11.2020, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2021, të aprovoi këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

Për caktimin e anëtarëve të komisionit për monitorimin e Kodit të Etikes

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim caktohen anëtarët e komisionit për monitorimin e Kodit të Etikes, në këtë përbërje:

1. _____, anëtar nga ekzekutivi;
2. _____, anëtar nga legjislativi;
3. _____, anëtar nga legjislativi;
4. _____, qytetar me integritet të dëshmuar;
5. _____, qytetar me integritet të dëshmuar.

Neni 2

Komisioni i Etikes monitoron zbatimin e kodit, dhe vepron sipas propozimeve individuale për përcaktimin e ekzistimit të një shkelje të kodit, paraqet raporte në kuvendin e komunës me rekomandime dhe ka kompetenca të tjera të përcaktuara me kod.

Neni 3

Mandati i komisionit të Etikes lidhet me mandatin e legjislaturës aktuale.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Gllogoc)
Zyra e Kryetarit
01 Nr. 030/01-20001 Dt. 17.05.2021



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-40 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr./2008, qershor 2008) dhe nenit 72 pika 72 germa (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, dhe Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike nenit 31 i ligjit bazik pas paragrafi i ri 31.6, duke pasur për bazë ndryshimin që është bërë në ligjin 04/L-111 i dt. 30.05.2012 nenit 18, Kryetari i Komunës mori këtë:

Propozim - Diskutimi i Raportit të punëve të Kompanive KRM"Pastrimi dhe KRU-Prishtina në Drenas.

Arsyetim

Referuar në ligjin nr.Nr.087 për Ndërmarrjet Publike që kompanit e lartëshenuara janë të obliguara që të raportojn kryetarit të komunës, bazuar në nenin 18 ligji 04/L-111 i dt.30 05.2012 ndryshimi dhe plotësimit të ligjit 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, Neni 31.6.Ligji bazik dhe neni 18 i ligjit 04/L-111 i dt. 30.05.2012 i cili thotë se Raportet Vjetore dhe Tremujore në form të informatës i dërgohen edhe Kryetarit të Komunës në të cilën ushtron veprimtarinë e Ndërmarrja Publike në pajtim me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale.

Lidhur me raportin e ndërmarrjeve të lartëshenuara mund të diskutohen sfidat dhe problemet në realizimin e punëve dhe aktiviteteve në këto kompani.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrocy
[Signature]

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		24.05 2021	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
13	052/06-21281		



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Komuna e Gllogocit

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë



Raport i punëve të kompanive KRM"Pastrimi dhe KRU"Prishtina në Drenas

Duke bazuar në ligjin nr.Nr.087 për Ndërmarrjet Publike që kompanit e lartëshenuara janë të obliguara që të raportojn kryetarin e komunës, bazuar në nenin 18 ligji 04/L-111 i dt.30 05.2012 ndryshimi dhe plotësimit të ligjit 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, Neni 31.6.Ligji bazik dhe neni 18 i ligjit 04/L-111 i dt. 30.05.2012 i cili thotë se Raportet Vjetore dhe Tremujore në form të informatës i dërgohen edhe Kryetarit të Komunës në të cilën ushtron veprimtarinë e Ndërmarrja Publike në pajtim me ligjin mbi vetëqeverisjen Lokale.

Pas analizes se raporteve janë vrejtur probleme dhe sfida me te cilat janë ballafaquar kompanit gjate vitit 2020, te cilat probleme kanë ndikojnë drejtperdrejti në jeten dhe mirëqenjen e qytetarve.

- Rrjeti I kanalizimit ne zonën urbane te qytetit ne Drenas është I ndertuar ne vitet 70 (shtatëdhjeta) I dimenzionuar për një periudhë te caktuar kohore e qe tani me rritjen e numrit te banorve në zonën urbane po paraqiten probleme te vazhdueshme me bllokime te shpeshta.
- Problemet kryesore me këto rrjeta janë:
- Kapaciteti jo mjaftueshem I gypave për qarkullimin normal te ujrave të zeza,
- Kyqjet jo profesionale te disa konsumatorve në rrjeta e ndertuara,

- Mungesa e rrjetave te kanalizimeve për ujra atmosferike
- Kombinimi I rrjetave te kanalizimit te ujrave te zeza me ujrat atmosferike
- Rrjeti shumë i vjetruar I gypave te kanalizimit te ujrave te zeza dhe veshtirësit në mirëmbajtje
- Mungesa e kapakve te pusetave te rrjetit si ato te ujrave te zeza ashtu edhe atmosferike,
- Pakujdesia edhe e konsumatorve ne shfrytëzimin e rrjetave te kanalizimeve.

Analizë e problemit

Gjatë shqyrtimit të problemit kemi arritur në përfundim, që për menjanimin e problemit të zbatohet legjislacioni në fuqi nga organet kompetente

Pëfundime:



- Ndririmi I gypave te kanalizimit te cilët nuk I plotësojn kushtet për rrjedhje normale te ujrave të zeza
 - Ndertimi I rrjetave te kanalizimeve atmosferike ne zonat ku nuk ka rrjeta,
 - Ndarja e ujrave te zeza nga ato atmosferike
 - Sigurimi I paisjeve adekuate per mirëmbajtje te rrjetave.
 - Mirëmbajtja përmanente e rrejtave
- Rritja e kapaciteteve për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit, kompania e ujësjellësit në nivel posedon vetem një paisje per mirembajtjen e kanalizimit



Ndërsa sa i përket zonave rurale shkaktohet e bllokimeve të kanlizimeve, gjatë verifikimit të gjendjes ne teren .


1. Hudhja e mbeturinave nga qytetarët e papërgjegjshëm në pusetat e kanalizimit.
2. Marja –thyerja e kapakve të pusetave të kanalizimeve.


3. Derdhja e ujërave Atmosferike në kanalizimin fekal sidomos nëpër kanalizimet që janë për gjatë tokave bujqësore si dhe në shumë raste edhe lidhje e ujërave të shtallave të kanalizimeve.
4. Punimet e rrugëve në shumicën e rasteve demtohen gypat e kanalizimeve.
5. Si dhe në disa fshatra seksioni i gypit të kanalizimeve nuk korospondon më numrin e ekonomive të kyqyra në këtë Kushtet atmosferike si shiu dhe vërshimet.

Sa për ilustrim në vijim janë fotot nga tereni:









Ndersa sa i perket shërbimit të menaxhimit të mbeturinave, pas shqyrtimit dhe analizimit të raportit të ardhur nga kompania është hartuar një rezyme si në vijim;

Bazuar në marrëveshjen për shërbimet primare të menaxhimit të mbeturinave midis komunës së Drenasit dhe KRM “Pastrimi” - Prishtinës, datë 27.01.2020, mbështetur në këtë kompania ndër të tjera angazhohet në grumbullimin, transportin dhe deponimin e mbeturinave komunale deri në vendin e caktuar.

Si informacion fillestar bazuar në raportet vjetore të kompanisë (viti 2020) numri i ekonomive familjare që pranojnë shërbim në ekonominë familjare është 80%, biznese 35% dhe institucione 92%. Vlera totale vjetore (viti 2020) e faturimit për të gjitha kategoritë (amvisëri, biznese, institucione dhe të veqanta) është 487,316.97 euro, ndërsa inkasimi vjetor për të gjitha këto kategori është 481,065.21 euro. Sasia totale vjetore e grumbullimit të mbeturinave nga KRM Pastrimi për vitin 2020 është 7,466.71 ton.

Drejtorati i DSHPE përgjatë vitit 2020 në vazhdimësi ka informuar përmes veb faqës së komunës se, kompania Pastrimi në fillim të këtij viti është ballafaquar me defekte në makineri, që ka rezultuar në moskryerjen e rregulltë në disa raste të shërbimit për grumbullimin e mbeturinave në territorin e komunës së Drenasit. Si rezultat i kësaj, janë mbajtur takime pune të vazhdueshme. Gjatë takimeve ndër të tjera temë diskutuese ka qenë ecuria e sistemit të menaxhimit të mbeturinave në komunën e Drenasit. Gjatë takimeve përfaqësuesit e kompanisë janë informuar mbi ankesat e qytetarëve për grumbullimin e mbeturinave, ku këto ankesa ndërlidhen edhe me raportet e dërguara nga kjo kompani se në ditë të caktuara në disa zona nuk ju kryhet shërbimi sipas orarit të caktuar. Nga kompania tregojnë se e gjithë kjo po ndodhë si rezultat i defekteve në makinerin, përkatësisht kamionat për bartjen e mbeturinave (problematika e makinerisë së vjetëruar dhe dëmtimi i shpeshtë i pjesëve). Si përfundim në këtë pikë diskutuese ne si drejtori kemi kërkuar që kompania të rritë kapacitetet e makinerisë funksionale për grumbullimin e mbeturinave në mënyrë që qytetarëve të ju ofrohet shërbimi i rregullt i mbeturinave dhe respektimi i marrëveshjes së lidhur midis komunës dhe KRM – Pastrimi për kryerjen e shërbimit primar të mbeturinave komunale.

Pas këtij takimi të realizuar deri më tani kompania në fjalë, bazuar në emailat e dërguar nga zyrtari i tyre, ende vazhdon të përballët me defekte në makineri dhe mos zbatim të itinerarit të plotë për grumbullimin e mbeturinave.

Si komunë cdo kemi vazhduar bashpunim me KRM duke mbështetur përmes granteve të performances. Nga granti i performancës mjedisi i pastër i vitit 2017 si aset për kompanin, një kamion tereni për grumbullimin e mbeturinave



Po ashtu edhe për grantet e fituara gjatë viteve 2018 dhe 2019, ku vlera e këtyre granteve të ndara nga Gizi do të investohet në ngritje të kapaciteteve për kompaninë që operon në grumbullimin e mbeturinave. Në kuadër të kësaj është bërë vlerësimi i nevojave për mjete, dy kamion tereni për grumbullim të mbeturinave. Deri më tani bazuar në informacionet nga gizi gjerman proceduar për sigurimin e paisjeve në kuadër të këtyre granteve janë në fazat e prokurimit dhe brenda këtij viti do të finalizohen.

Përfundime:

Pas skadimit të afatit të “ Planit të menaxhimit të mbeturinave”, është formuar grupi punues në kordinim me GIZ, do të fillojnë me harimin, plotësim dhe nryshim të Planit për menaxhimin

embeturinave për vitin 2021/25 dhe do të inkorporohen objektivat për themelimin e një Ndërmarrje publike për menaxhim të mbeturinave në kuadër të komunës.

Drejtoria e shërbimeve publike dhe Emergjencë

